

VENDIM
Nr.256, datë 27.2.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË TJERA STUDIMI PRANË SHKOLLËS SË LARTË
UNIVERSITARE PRIVATE “UNIVERSITY OF NEW YORK -TIRANA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare private “University of New York - Tirana”, Tiranë, për hapjen e programeve të studimit “Master i nivelit të parë” për:

- a) administrim biznesi;
- b) administrim biznesi, me profil bankar.

2. Kohëzgjatja e këtyre programeve do të jetë nga 16 deri në 19 muaj, në plotësimin e të paktën 60 krediteve. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diploma “Master i nivelit të parë”.

3. Ngarkohet “University of New York - Tirana” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. “University of New York – Tirana” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. “University of New York – Tirana” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha